

**UDHËZIM**  
**Nr.45, datë 10.11.2009**

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.7, DATË 16.6.2003 “PËR AKCIZAT”, I**  
**NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ministri i Financave

**UDHËZON:**

1. Pika 2.12 e udhëzimit nr.7, datë 16.6.2003 “Për akcizat”, i ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

2.12. Importuesit e “Malto”, “Letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër” (kjo e fundit me kodin e NC 48 13 10 000 000), që nuk janë të autorizuar si tatimpagues akcize, subjekte të prodhimit të birrës dhe cigareve, duhet të bëjnë kërkesë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për të marrë autorizimin për importimin e maltos dhe letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, për qëllime tregtie. Autorizimi lëshohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe jepet për një periudhë 1-vjeçare me të drejtë përsëritje. Çdo subjekt që do të bëjë kërkesë për autorizim si importues i maltos dhe letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, për qëllime tregtie, duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë më shumë se 3 vjet i regjistruar në organet tatimore si person i tatueshëm i TVSH-së.

b) Të jetë duke vazhduar veprimtarinë e vet ekonomike.

c) Të mos ketë detyrime tatimore të pashlyera.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për çdo autorizim të lëshuar për tatimpaguesit si importues të maltos, letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër.

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zhdoganimi i “letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër” të bëhet me copë.

Importuesi i Autorizuar, për çdo rast të importimit të maltos, letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtrin, duhet të depozitojë si garanci përpara zhdoganimit, në një llogari bankare, 120 lekë për kg malto të importuar dhe 50 lekë për 20 copë “letër cigare në formë tubi, bashkë me filtrin” garanci (zhdoganimi për letrën e cigares në formë tubi, bashkë me filtër, do të bëhet në copë), e cila do t’i kthehet brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentacionit të shitjes së maltos dhe letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, tek tatimpaguesit e autorizuar si prodhues birre dhe prodhues cigare.

Në rastet kur një tregtari të autorizuar për importimin e maltos ose letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër, i gjenden sasi të maltos, letrës së cigares në formë tubi, bashkë me filtër të padokumentuara ose vërtetohen shitje te persona të paautorizuar si prodhues birre, prodhues cigare, ndaj tij aplikohen sanksionet e parashikuara në ligjin nr.8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe i hiqet e drejta e ushtrimit të këtij aktiviteti duke i tërhequr autorizimin si importues malto, letre cigare në formë tubi, bashkë me filtër, për një periudhë 2 vjeçare. Organi tatimor ka të drejtë të mbajë garancinë e depozituar për kompensimin e dëmit ekonomik. Nëse personi nuk ka garanci ose ajo nuk është e mjaftueshme për përballimin e dëmit ekonomik, tatimpaguesi paguan shumën totale ose pjesën që nuk mbulohet nga garancia, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vlerësimit nga organi tatimor. Në të kundërt organi tatimor zbaton procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE  
**Ridvan Bode**